



**MBROJTJA LUMORE NE UREN E SHEMRIZES
– BASHKIA GRAMSH**

RAPORTI TEKNIK

Projektues: "ZENIT & CO"sh.p.k

Tiranë, 2024

Arqile
Peri

Digitally signed by
Arqile Peri
Date: 2026.07.02
09:31:29 +02'00'

MBROJTJA LUMORE NE UREN E SHEMRIZES, BASHKIA GRAMSH

1. HYRJE


Ky raport teknik është hartuar për projektin e mbrojtjes lumore në zonën e Urës së Shëmrizes, në Bashkinë Gramsh. Qëllimi i projektit është stabilizimi i brigjeve të lumit, parandalimi i proceseve të erozionit dhe mbrojtja e infrastrukturës rrugore dhe urës nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga prurjet e larta.

Gjatë viteve të fundit janë konstatuar dëmtime të vazhdueshme të brigjeve, të shkaktuara nga rrjedha e lumit gjatë periudhave me reshje intensive dhe prurje të mëdha. Këto procese kanë rritur rrezikun për sigurinë e urës, të rrugës dhe të pronave përreth.

Për këtë arsye është parashikuar ndërtimi i një sistemi mbrojtës lumor me gjatësi totale 445 m, i projektuar për të garantuar stabilitet afatgjatë.

2. OBJEKTIVAT

Lumi Devoll buron në kembe të malit Gramozit, vazhdon rrjedhën e vet në veri drejt qytetit të Bilishtit, për t'u kthyer më pas në perëndim nëpër grykën midis Malit të Thate në veri dhe Moraves në jug, ku bashkohet në thellesi me lumin Osum, që buron po nga Gramozi, dhe formojnë së bashku lumin Seman.



Arqile
Peri

Digitally signed by
Arqile Peri
Date: 2026.07.02
09:31:29 +02'00'

MBROJTJA LUMORE NE UREN E SHEMRIZES, BASHKIA GRAMSH

Siperfaqja e ujembledhese eshte 3139 km² dhe lartesia mesatare mbi nivelin e detit eshte rreth 960 m. Prurja mesatare e Devollit eshte 49.5 m³/s, ushqehet kryesisht nga ujerat siperfaqesore. Duke qene nje nga lumenjte me te medhenj ne vendin tone Devolli eshte nje lum i "rezikshem" persa I perket gerryerejes se tokave dhe permbytjeve.

Kjo gerryerje vazhdon nga dita ne dite si ne avancim ne drejtim te tokave bujqesore ashtu edhe ne gjatesi ne vijim te lumit. Shkak i kesaj gerryerje eshte edhe devijimi i lumit Devoll si shkak i mbushjes nga aluvionet e sjella nga lumi edhe si rrjedhoj eshte devijuar rrjedha e lumit.

3. QËLLIMI I PROJEKTIT

Projekti synon mbrojtjen nga geryerjet e bregut te krahut te majte te rrjedhes se lumit te Devollit ne zonen e Ures Shemrizes ne te gjithe gjatesine e verejtur te geryerjes se tij dhe te demtimit te tokave bujqesore. Me poshte po paraqesim pamje nga zona e gerryerjes.

4. ZGJIDHJA TEKNIKE

Gjatesia e segmentit qe i eshte ekspozuar geryerjeve intensive eshte rreth 445 ml ne shtratin e lumit qe ku me e theksuar kjo gerryerje eshte ne pjesen e fillimt dhe qendrore te mbrojtjes. Zgjidhja teknike qe eshte menduar ti jepet kesaj mbrojtje eshte me nje

Argjinaturë me lartësi 5.40 m;

Gjerësi kurore 3.00 m;

Pjerrësi e faqes nga lumi 1:1.5;

Pjerrësi e faqes nga toka 1:1.5;

Mbushje me zhavorr të përzgjedhur dhe të ngjeshur;

Veshje me beton M-200, trashësi 15 cm, e armuar me rrjetë çeliku Ø8 mm me hapje 15×15 cm;

Dhëmb betoni në këmbën e skarpatës për mbrojtje nga gërryerja.

Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x0.5 m

Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1 m


Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m

Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x2x2 m

Arqile
Peri

Digitally signed by
Arqile Peri
Date: 2026.07.02
09:31:29 +02'00'

MBROJTJA LUMORE NE UREN E SHEMRIZES, BASHKIA GRAMSH



Prerje tip e mbrojtjes $L=445\text{ m}$

Lumi Devoll, duke qene nje nder lumenjte me te medhenj ne vendin tone, prurjet e ngurta qe ai sjell jane te medha e per kete arsye shtrati ka devijuar nga gjurma e tij duke devijuar ne drejtim te tokave.

Per kete arsye, fillimisht eshte menduar nje pastrim i shtratit te lumit nga aluvionet me nje trashesi rreth 40 ÷ 50 cm duke vijuar me tej me ndertimin e argjinatures per devijim lumi (siperfaqe ku eshte parashikuar ndertimi i mbrojtjes lumore) gje e cila do te sjelle ndryshimin e drejtimit te rrjedhes duke lehtesuar proceset ndertimore te argjinatures me gure dhe gabionet.

Per kete arsye kjo mbrojtje lumore do te inkastrohet ne argjinate me gure ≥ 50 cm duke u vazhduar me tej me rreshta Gabione, dhe te dyja bashke do te bejne mbrojtjen e tokave dhe kthimin ne shtratin e tij te lumit Devoll.

Lumi Devoll, duke qene nje nder lumenjte me te ne vendin tone, prurjet e ngurta qe ai sjell jane te medha e per kete arsye shtrati ka devijuar nga gjurma e tij duke u devijuar ne drejtim te tokave. Per kete arsye, eshte menduar nje pastrim i shtratit te lumit nga aluvionet me nje trashesi rreth 40 ÷ 50 cm, ne nje sipërfaqe te percaktuar ku si rrjedhoj drejtimi i rrjedhes do te ndryshoj ne drejtim te rrjedhes se tij te meparshme.

Per kete arsye kjo mbrojtje lumore do te inkastriohet ne argjinature e do te krijohet si nje trup i vetem, dhe te dyja bashke do te bejne mbrojtjen e tokave dhe kthimin ne shtratin e tije te lumit Devoll.

5.ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Per ndertimin e objektit *“Mbrojtja Lumore ne Uren e Shemrizes*, projekti parashikon te perdoren materiale te cilesise se larte sipas standarteve te vendit dhe atyre nderkombetare. Te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve.

Gjate ndertimit te ketij objekti te kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Germimet per bazamentin e mbrojtjes dhe devijimit e pastrimit te shtratit jane parashikuar me mjete.
- 2.- Rrjetat e gabioneve do te realizohen sipas detajit te projektit (kosha me rrjete teli me dopio perdredhje me thurje heksagonale me tipin e rrjetes 8x10 cm, sipas standartit EAD-200039-00-0102 me veshje Zn).
- 3.-Mbushja me zhavorr te zgjedhur do te realizohet sipas specifikimeve dhe detajit teknik ne projekt.

6.KONKLuzionet

Gjate projektimit jane marre parasysh te gjithë faktoret e nevojshem per te siguruar qe projekti ne fjale te jete funksional, efikas dhe i thjeshte ne ndertim. Ne dimensionim jane marre ne konsiderate gjendja ekzistuese e lumit, relievi dhe perspektiva e zhvillimit te zones.

SHOQERIA “ZENIT & CO”sh.p.k
ADMINISTRATOR
Arqile PERI

Arqile
Peri

Digitally signed by
Arqile Peri
Date: 2026.07.02
09:31:29 +02'00'

MBROJTJA LUMORE NE UREN E SHEMRIZES, BASHKIA GRAMSH